



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 06, datë 01. 02. 2023

**“PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË TË  
PALUAJTSHME PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA PROJEKTI,  
“RIGJENERIMI URBAN I ZONËS AFËR GJIMNAZIT,  
NË RRUGËN E DËSHMORËVE, ÇOROVODË”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 01. 02. 2023, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, neni 9, pika 1.2, germa “ b”; nenit 54, Ligjin Nr.8561, datë 22. 12. 1999 “Për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive private për interes publik”, i ndryshuar, VKM-në Nr. 127, datë 23. 03. 2000, “Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, VKM-në Nr.138, datë 23. 03. 2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, VKM-në Nr.89, datë 03. 02. 2016, “Për miratimin e Hartës së Vlerës së Tokës në Republikën e Shqipërisë”, Komisionit për Vlerësimin Paraprak dhe Përgatitjen e dokumentacionit të shpronësimeve për Interes Publik”

VENDOSI:

1. Miratimin e procedurës së shpronësimit, për interes publik, të pronarit të pasurisë të paluajtshme pronë private, që preket nga realizimi i projektit, **“Rigjenerimi urban i zonës afër Gjimnazit në Rrugën e Dëshmorëve, Çorovodë”**.
2. Pronari i pasurisë të paluajtshme që shpronësohet, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë të llojit , “ndërtesë”.
3. Vlera financiare e shpronësimit për interes publik prej: 675 000 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e pese mijë ) lekë, do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Skrapar, zëri “shpronësime “.

Emri Pronarit	Nr. Pasurisë	Lloji i Pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja që shpronësohet	Vlera financiare	Shënime
Batjar Ibrahim Laze	11/51	Ndërtesë	1420	18 m <sup>2</sup>	675 000	Konfirmim nga ASHK Skrapar

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Tatim Taksave.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikes 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Vendimi u miratua me 9 vota pro , vota kundër - s'ka , vota abstenim – s'ka .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .



**KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK**

**Edlira SHKËMBI**